



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1120/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, për shkak të vendosjes së posterit - banerit në afërsi të Qendrës së Votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.1120/2021 e datës 14.11.2021 , e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti t'i shqiptohet gjobë për shkak të vendosjes së posterit-banerit në afërsi të Qendrës së Votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 14.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1120/2021, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Viti, përkatësisht kandidati për kryetar komune të Vitisë Arsim Ademi nga subjekti politik ka vendosur material Zgjedhor në baner të kandidatit në një distancë me pak se 100 metra distancë nga Qendra e Votimit shkolla 28 Nëntori në fshatin Vërban Komuna e Vitisë. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika a) të LZP-së.

Më tej parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar të kandidatit për Kryetar Komune nga Subjekti Politik LVV-së Arsim Ademi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën që është bërë ndaj tij dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj saj deri më datë 14.11.2021, në ora 17:00. Në përgjigje në ankesë të datës 14.11.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), konsideron se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës janë jo të drejta dhe të pabazuara, për faktin se baneri i lartcekur nga lokacioni që shihet në fotografi është në distancë më tepër se 100m nga qendra e votimit dhe se për vendosjen e këtij baneri ekziston edhe pëlqimi i pronarit për vendosjen e këtij baneri. Si dëshmi ka bashkangjitur pëlqimin e dhënë të datës 12.11.2021 të pronarit Nadir Sokolit nga fshati Vërban komuna e Vitisë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se në afërsi të shkollës 28 Nëntori në fshatin Vërban Komuna e Vitisë aktivistet e subjektit politik LDK kanë hasur një baner reklamuese të kandidatit për kryetar të Komunës së Vitisë Arsim Ademi nga subjekti politik LVV të ngjitur në afërsi të shkollës në më pak se 100 metra nga qendra e votimit.

Neni 85.1 i LZP-së përcakton: “ *Të gjitha subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendër të votimit në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-se ose Menaxheri i QV-se. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar ose janë gjetur duke postuar materiale të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.* ”.


Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se baneri në fjalë është vendosur afër ndonjë Qendre të Votimit, për të cilën pretendohet në ankesë sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se objekti në fjalë është shkolla fillore 28 Nëntori në fshatin Vërban Komuna e Vitisë dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar si

Qendër e Votimit, në ditën e votimit. Për aq me tepër sipas dispozitës se me sipërme (Neni 85.1 i LZP-së), largimi i materialeve do të duhej të kryhej nga ana e anëtareve të KVV-së ose menaxherit të QV-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Anr.1120/2021 më datën 15.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Milena Derić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.